



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar mbi auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për Programin “Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit GOVTECH”

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**“PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (AKSHI)
PËR PROGRAMIN “PËRMIRËSIMI I AKSESIT TË
BARABARTË NË SHËRBIMET PUBLIKE TË STANDARTIT TË
LARTË NËPËRMJET OPERACIONIT GOVTECH”**

Tiranë, 2024

	Përmbajtja	1
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
	a) Përshkrim i shkurtër për programin nën auditim b) Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij c) Qëllimi i auditimit d) Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave e) Nga shqyrtimi i evidencave, f) Paraqitja e gjetjeve kryesore g) Paraqitja e rekomandimeve kryesore	
	1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	6
II	HYRJE	8
	1. Objektivat dhe qëllimi 2. Identifikimi i çështjes 3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 4. Përgjegjësitë e audituesve 5. Kriteret e vlerësimit 6. Standardet e Auditimit 7. Metodatat e auditimit 8. Dokumentimi i auditimit	
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11
1	Informacioni i përgjithshëm mbi programin nën auditim	11
2	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	11
Pika 1	Auditimi i llogarive 600 – 606, shpenzimet korente	14
Pika 2	Auditimi i shpenzimeve kapitale	27
IV.	REKOMANDIME	29

I-PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për programin nën auditim

Me ligjin nr. 45/2023 është ratifikuar marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për “Përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech”, Projekti Nr. ID P177845.

Marrëveshja e huasë Nr. 9483-AL për Përmirësimin e Aksesit të Barabartë në Shërbime Publike me Standard të Lartë përmes Operacionit GovTech - (“Operacioni”), u nënshkrua midis Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”) dhe Republikës së Shqipërisë më 20 Prill 2023. Objektivi i operacionit është të shtojë qasjen e barabartë dhe të rrisë cilësinë e shërbimeve digjitale të përzgjedhura. Operacioni hyri në fuqi më 18 korrik 2023 dhe data e mbylljes së tij është 31 maj 2028. Shuma totale e huasë nuk do të kalojë 60 milion Euro, dhe përfshin (i) një pjesë prej 55.3 milion Euro dhënë si Program për Financimin e Rezultateve për të plotësuar financimin e Programit siç përshkruhet më poshtë, dhe (ii) një pjesë prej 4.7 milion Euro dhënë si financim të asistencës teknike për të ndihmuar në zbatimin e Programit.

Në bazë të Marrëveshjes së Huasë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, (AKSHI) është përgjegjëse për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e përgjithshëm të Operacionit. Për monitorimin e Operacionit është përgjegjës një Njësi Koordinuese (“Njësia Koordinuese”), e krijuar pranë AKSHI-së. Ministrinë e linjës që kontribuojnë dhe luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në zbatimin e Programit, duke përfshirë Ministrinë e Financave (MF), Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHPS) dhe Ministrinë e Brendshme (MPB), të cilat do të bashkë drejtojnë (në emër të ofruesve të shërbimeve përkatëse në varësi të tyre) riorganizimin dhe racionalizimin i shërbimeve (lidhur me Grupin e Rezultateve 1(ii)); dhe Ministria e Arsimit (MASH) e cila do të udhëheqë aktivitetet në SmartLabs nga këndvështrimi arsimor dhe mësimor, duke përfshirë zhvillimin dhe vendosjen e përmbajtjes mësimore, ngritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe përmirësimin e kurrikulës, si dhe sigurimin e të dhënave për sistemin e monitorimit dhe llogaridhënies së të mësuarit dhe Njësitë bazë të Qeverisjes Vendore, (pjesa e menaxhimit të aktiveve të shkollave),

Programi përbëhet nga aktivitetet e mëposhtme në kuadër të Programit të Transformimit Digjital të Qeverisë, me një vlerë totale të vlerësuar prej 136.6 milionë USD:

Programi është i formatit PforR, Program for Results, program me qasje rezultati, i fokusuar në arritjen e objektivave të matshme objekt i projektit, pagesat e të cilit bazohen në përmbushjen e treguesve të matshëm të performancës. (DLI, Disbursement Link Indicator).

Objekti i zhvillimit të **Përmirësimit të Aksesit të Barabartë në Shërbimet Publike Standarde të Larta nëpërmjet operacionit GovTech (Programi)** është rritja e aksesit të barabartë dhe cilësisë së shërbimeve dixhitale të përzgjedhura. Programi do të mbështesë programin e transformimit dixhital të qeverisë dhe është i strukturuar rreth tre fushave të rezultateve:

1. përmirësimi i cilësisë së shërbimit elektronik dhe përvojës së përdoruesit;
2. përmirësimi i aftësive dixhitale dhe përfshirja dixhitale; dhe
3. forcimi i përdoruesve prioritarë të GovTech.

Huaja është 60 milion euro dhe ka si objekt për të ndihmuar në financimin e programit dhe projekteve si vijon:

-Objekti i Programit është të rrisë aksesin e barabartë dhe cilësinë e shërbimeve dixhitale të përzgjedhura. Programi përbëhet nga aktivitetet e mëposhtme në kuadër të Programit të Transformimit Dixhital të Huamarrësit dhe pasardhësi i tij:

Fusha 1 e rezultateve: Rritja e cilësisë së shërbimit elektronik dhe përvojës së përdoruesit. Përmirësimi (a) i përdorshmërisë, efikasitetit dhe pro-aktivitetit të portalit e-Albania; dhe, (b) cilësinë e shërbimeve dixhitale, për të ofruar zgjidhje të avancuara, proaktive në platforma të sigurta dhe për të përmirësuar standardet e shërbimit dixhital nëpërmjet:

- (i) ri-inxhinierimi i portalit e-Albania bazuar në aksesueshmërinë dhe përvojën e përdoruesit (UX);
- (ii) sigurimin e shërbimeve elektronike standarde të larta, të personalizuara dhe proaktive të bazuara në ngjarje; dhe
- (iii) përmirësimi i shtyllës kurrizore të shërbimeve elektronike: portali e-Albania dhe infrastruktura e TIK-ut të Government Gateway dhe vazhdimësia e biznesit.

Fusha 2 e rezultateve: Përmirësimi i Aftësive Digjitale dhe Përfshirja Digjitale. Transformimi i të nxënit, modernizimi i shërbimeve ndaj klientit dhe garantimi i qasjes për të gjithë qytetarët përmes:

- (i) Përmirësimin të aftësive digjitale dhe themelore përmes Laboratorëve Inteligjentë të Edukimit të përzgjedhur; dhe
- (ii) Përmirësimin të shërbimit ndaj klientit dhe qasjes përmes: (a) një qendre të re kontakti që përfshin të gjithë kanalet e komunikimit (*omnichannel contact center*) të e-Albania plus pika informacioni fizike për ofrimin e ndihmës shtesë; dhe (b) ngritjes së qendrave të inovacionit rinor për zhvillimin e zgjidhjeve për sfidat sociale, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara, dhe për ofrimin e trajnimeve në fushën e aftësive digjitale për grupet e të rinjve.

Fusha 3 e Rezultateve: Forcimi i Mundësuesve Prioritet të GovTech. Mbështetje për (a) forcimin e qeverisjes së të dhënave, sigurinë dhe transparencën e të dhënave; dhe (b) miratimin e sistemeve dixhitale, kërkesave dhe proceseve inteligjente mundësuese nëpërmjet:

- (i) forcimi i qeverisjes së të dhënave si një mundësues “i të gjithë qeverisë” për të siguruar platforma të sigurt (për të reduktuar rrezikun dhe ndikimin e sigurisë kibernetike), mbrojtjen e të dhënave me dizajn dhe parazgjedhje, shkëmbimin e të dhënave dhe Open Data; dhe
- (ii) forcimin e mundësive institucionale të përzgjedhura “të gjithë qeverisë” për të siguruar: (a) një sistem të përmirësuar për monitorimin e ofrimit të shërbimeve (SQDNE); (b) një tranzicion i përshpejtuar drejt një qeverie pa letra (EDRMS); dhe (c) pajtueshmërinë me kërkesat e përzgjedhura të dixhitalizimit të anëtarësimit në BE.

Financimi në total i programit dhe projekteve është 136.5 milion USD nga të cilat Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) do të financojë 60 milion USD dhe AKSHI dhe MAS do të financojnë vlerën 76,5 milion USD.

MAS do të udhëheqë aktivitetet në SmartLabs nga perspektiva arsimore dhe mësimore, duke përfshirë zhvillimin dhe vendosjen e përmbajtjes mësimore, ndërtimin e kapaciteteve të mësuesve dhe përmirësimin e kurrikulës, si dhe sigurimin e të dhënave për sistemin e monitorimit dhe llogaridhënies së mësimdhënies. Akshi do të fokusohet në aspektet infrastrukturore të TIK-ut të 200 Smart Labs.

b. Rëndësia e programit dhe auditimit të tij

Agjenda Digjitale Shqipëri 2022–2026, si strategjia e AKSHI-it, është një dokument strategjik i cili synon të nxisë investimet në zonat kyçe të informatikës së avancuar dhe përpunimit të të dhënave, inteligjencës artificiale (IA), sigurisë kibernetike dhe aftësive të përparuara digjitale të nevojshme për t'i zhvilluar ato. Ajo ka potencialin për të lidhur bizneset, administratën publike dhe qytetarët me teknologjitë dhe burimet më të fundit dhe do të ndihmojë në të qenit konkurrues globalisht dhe autonome strategjikisht, duke e zhvilluar dhe drejtuar shoqërinë drejt transformimit digjital. Qëllimi i këtij dokumenti është vendosja e synimeve për vitet e ardhshme duke ndjekur platformat moderne të të dhënave dhe teknologjive digjitale për t'u njohur me nevojat e qytetarit, kapërcimin e mungesës së burimeve dhe përshtatjen me mënyrën e re të punës në distancë duke avancuar më tej me digjitalizimin e shërbimeve të qeverisë dhe zhvillimin e aftësive kibernetike.

c. Qëllimi i auditimit

Auditimi financiar i pasqyrave financiare të programit do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) – dhe standardet e kontrollit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi financiar do të ketë në fokus ISSAI 200 Parimet e Auditimit Financiar dhe ISA 800 (ISSAI 2800, Konsiderata të veçanta, auditime të pasqyrave financiare të hartuara sipas një kuadri të veçantë.

Këto standarde kërkojnë që auditimi të planifikohet dhe të kryhet për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin ekzaminimin, në bazë të testit të detajeve që mbështesin shumat dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Ky auditim përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave të programit dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

-Nëse pasqyrat financiare për qëllime të veçanta japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;

-Nëse të gjitha fondet e jashtme janë përdorur në përputhje me kushtet e marrëveshjeve përkatëse të financimit;

Grupi i auditimit ka audituar llogaritë e shpenzimeve të pagave dhe korente (llogaritë 600-606), dhe llogaritë e shpenzimeve kapitale të Programit. (Pjesë e pasqyrave financiare të AKSHI, periudha vjetore 2023).

Grupi i auditimit ka verifikuar që pasqyrat financiare të programit janë përgatitur në përputhje me kushtet e marrëveshjes së financimit (huaja Nr. 9483-AL).

Kjo përfshin verifikimin e afatit kohor të përgatitjes dhe dorëzimit dhe klasifikimin e shpenzimeve të raportuara.

(b) Grupi i auditimit ka shqyrtuar nëse programi ka respektuar kushtet e marrëveshjes së financimit që kërkon mbajtjen e librave të duhur të llogarisë, për:

- të përcaktojë nëse llogaritë financiare mbështeten siç duhet nga dokumentacioni justifikues dhe dokumentacioni mbështetës;

- raportime për përjashtime dhe dobësi të rëndësishme në lidhje me kërkesat e kontabilitetit, mbajtjes së të dhënave dhe dokumentacionit që kërkojnë veprime korrigjuese.

(c) Grupi i auditimit ka rakorduar informacionin në Pasqyrat Financiare me sistemin e kontabilitetit dhe regjistrimet (p.sh., libri kryesor, librat e tjerë, bilanci i provës, likuiditeti, etj)

(d) Grupi i auditimit ka verifikuar që shpenzimet e projektit janë klasifikuar në përputhje me linjat buxhetore të miratuara dhe se shumat e buxhetuara nuk janë tejkaluara.

(e) Grupi i auditimit ka shqyrtuar se për procesin e blerjes së SmarLab-eve subjekti ka zhvilluar procedura prokurimi sipas kuadrit ligjor, ka lidhur kontratat përkatëse dhe më pas shoqëruar me faturën fiskale.

(f) Grupi i Auditimit ka kryer procedura për të përcaktuar nëse ato ekzistojnë ose janë përdorur për qëllimet e tyre të synuara në përputhje me kushtet e marrëveshjes së financimit, dhe nëse procedurat e kontrollit ekzistojnë dhe janë vendosur në veprim për t'i mbrojtur ato në mënyrë

adekuate. Si pjesë e procedurave për të përcaktuar nëse ato janë përdorur për qëllimet e synuara, audituesit kanë kryer rishikime të përdorimit përfundimtar për një mostër të përshtatshme të të gjithë zërave bazuar në vlerësimin e rrezikut të kontrollit. Rishikimet e përdorimit përfundimtar përfshijnë vizita në terren për verifikimin e ekzistencës së tyre ose përdorimin e tyre për qëllimet e tyre të synuara në përputhje me objektivat e projektit.

(g) Grupi i auditimit ka shqyrtuar nëse shpenzimet e programit kanë qenë legjitime, duke përfshirë zbatimin e udhëzimeve kundër korrupsionit të BB-së, kufizimet që lidhen me prokurimet në shkallë të gjerë dhe firmat e hequra nga ndalimi.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim në lidhje me transaksionet e kryera ka dokumentet justifikuese dhe mbështetëse.

Një problematikë e konstatuar është: Në procesin e marrjes në dorëzim të aktiveve nga organet vendore me përgjegjësinë përkatëse, u konstatuan mospërputhje në zbatimin e neneve 42,43 dhe 50 të kapitullit “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” dhe nenit 57 të kapitullit “Veprimet që kryejnë strukturat e Nepunesit Zbatues” të Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

-Të merren masa nga strukturat drejtuese të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, **Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Zyrave Vendore Arsimore, Njësive bazë të Qeverisjes Vendore, (pjesa e menaxhimit të aktiveve të shkollave)**, që procesi i kalimit të aktiveve nga AKSHI-MAS-ZVA-Njësi bazë të Qeverisjes Vendore të kryhet me ngritjen e grupeve përkatëse të marrjes në dorëzim, në përputhje të plotë me Udhëzimin 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të programit “Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech”, përcaktuar si pasqyra financiare për qëllime të veçanta, (ISSAI 2800) dhe shënimet shpjeguese përkatëse në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe regjistrimet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të programit.

Opinioni i pa modifikuar¹ :

“Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme si dhe të përshtatshme të auditimit, në pasqyrat financiare vjetore të Programit “Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit

¹ -Manuali Auditimit Financiar, llojet e opinioneve, fq. 55-66. -(e shkëputur nga ISSAI 200) Forma e opinionit 147. Audituesi duhet të japë një opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Govtech”, përcaktuar si pasqyra financiare për qëllime të veçanta, (ISSAI 2800) nuk u evidentuan anomali ose mospërputhje materiale në kuadër të kornizës së zbatueshme financiare dhe në gjykimin profesional të audituesit të pavarur justifikojnë dhënien e një opinionit të pa modifikuar.

Baza për opinionin e pa modifikuar:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n, ISSAI 200 Parimet e Auditimit Financiar dhe ISA 800 (ISSAI 2800, Konsiderata të veçanta, auditime të pasqyrave financiare të hartuara sipas një kuadri të veçantë. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, është përgjegjëse për paraqitjen e saktë dhe me besueshmëri të pasqyrave financiare të projektit.

Përgjegjësia audituese të KLSH, është që të shprehin një opinion për pasqyrat financiare, ose pjesë të tyre në bazë të auditimit të kryer. Përgjegjësia e audituesve të KLSH, lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare të projektit në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, për shkak të gabimit apo mashtrimit, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Ne gjithashtu: Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidence auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Gjatë vlerësimit të risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga subjekti, në mënyrë që të përcaktojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të subjektit. Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga subjekti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

II - HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1132/1 prot., datë 23.09.2024, nga data 23.09.2024 deri në datën 31.10.2024, KLSH kreu auditimin financiar në **Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit** me periudhë auditimi nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Auditimi i përputhshmërisë u krye nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. B.Shi, Përgjegjës grupi
2. A.Xh, Audituese
3. A.Gj, Audituese
4. A.C, Auditues

1. Objektivat dhe qëllimi:

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi 2023, në llogaritë 600-606 dhe 230, (kodi i projektit, 20AD447, Implementimi i Laboratorëve Smart), përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse. Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar, i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë dhe të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

2. Identifikimi i çështjes

-Me ligjin nr. 45/2023 është ratifikuar marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për “Përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech”, ID P177845.

Objektivi i zhvillimit të Përmirësimit të Aksesit të Barabartë në Shërbimet Publike Standarde të Larta nëpërmjet GovTech (Programi) është rritja e aksesit të barabartë dhe cilësisë së shërbimeve dixhitale të përzgjedhura. Programi do të mbështesë programin e transformimit dixhital të qeverisë dhe është i strukturuar rreth tre fushave të rezultateve: 1. përmirësimi i cilësisë së shërbimit elektronik dhe përvojës së përdoruesit; 2. përmirësimi i aftësive dixhitale dhe përfshirja dixhitale; dhe 3. forcimi i mundësuesve prioritarë të GovTech.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, është përgjegjëse për paraqitjen e saktë dhe me besueshmëri të pasqyrave financiare të projektit, dhe bashkë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Zyrat Vendore Arsimore, Njësitë bazë të Qeverisjes Vendore, (pjesa e menaxhimit të aktiveve të shkollave), kanë përgjegjësi për zbatimin e objektit të projektit dhe hartimin e inventarizimit në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe

zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia audituesve të KLSH, është që të shprehin një opinion për pasqyrat financiare, ose pjesë të tyre në bazë të auditimit të kryer. Përgjegjësia e audituesve të KLSH, lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare, (llogaritë përkatëse) në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, për shkak të gabimit apo mashtrimit, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Ne gjithashtu: Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidence auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Gjatë vlerësimit të risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga subjekti, në mënyrë që të përcaktojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të subjektit. Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga subjekti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC, ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë 9 përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n, ISSAI 200 Parimet e Auditimit Financiar dhe ISA 800 (ISSAI 2800, Konsiderata të veçanta, auditime të pasqyrave financiare të hartuara sipas një kuadri të veçantë.

Gjithashtu dhe Akte të tjera ligjore apo nënligjore që kanë rezultuar të nevojshëm gjatë auditimit. Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; -Ligji Nr. 45/2023 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për “Përmirësimin e Aksesit të Barabartë në Shërbimet Publike të Standardit të Lartë Nëpërmjet Operacionit Govtech”, Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së; zbatimi i udhëzimeve kundër korrupsionit të BB-së, kufizimet që lidhen me prokurimet në shkallë të gjerë dhe firmat e hequra nga ndalimi.

6. Standardet e auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

7. Metodat e auditimit

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodatat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

- a. *Metoda "Testim hap pas hapi"*: Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësia publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.
- b. *Metoda e ekzaminimit*: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve.
- c. *Metoda e testimit të detajuar*: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidencë më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.
- d. *Metoda e inspektimit fizik*: Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme në lidhje me çështjet nën auditim.
- e. *Metoda e intervistimit*: Është konsideruar si një nga metodatat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacional gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit". Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi programin nën auditim

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është krijuar sipas "Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit". Kjo agjenci është bërë funksionale me emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të saj në Shtator të vitit 2007.

Objekti i veprimtarisë së AKSHI-t

- a) Zbatimin e politikave e të strategjive, për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit (më poshtë SHI) dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (më poshtë TIK);
- b) Bashkërendimin e programeve në fushën e SHI-së dhe në veçanti të TIK-ut;
- c) Nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së;
- ç) Hartimin e praktikave për ushtrimin e kompetencave që i jepen ministrit nga legjislacioni në fushën e komunikimeve elektronike;
- d) Promovimin e teknologjive të reja në fushën e SHI-së;
- dh) Dhënien e kontributit në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

Shpenzimet e pagave që i akordohen Programit përbëjnë 20% të totalit të shpenzimeve të pagave të AKSHI të parashikuar për periudhën e zbatimit të programit. Kjo përfshin pagat e (i) punonjësve në selinë e AKSHI-së në Tiranë; (ii) stafin e AKSHI-së në ministritë e përzgjedhura të linjës prioritare, përfshirë MASH-in, MASH-in dhe MPB-në.

Shpenzimet e tjera korrente që i akordohen Programit përbëjnë 20% të totalit të buxhetit të mallrave dhe shërbimeve të AKSHI-t për periudhën e zbatimit të programit. Të dhënat historike tregojnë se ky zë përbëhet nga kostoja e mirëmbajtjes së sistemit, asistencë teknike dhe shërbimet komunale dhe telekomunikacioni.

Pasqyrat financiare të programit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023, janë përgatitur me qëllim të respektimit të parashikimeve të marrëveshjes së huasë Nr. 9483-AL, letrës së disbursimit dhe kushteve të përgjithshme për Programin, që do të thotë “Kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e IBRD-së, Financimi Program-për-Rezultat”.

Pasqyrat financiare të Programit përfshijnë Pasqyrën e Shpenzimeve të Programit (Pagesave); dhe Pasqyrën e Krahasimit të Planit të Programit me Realizimin, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Pasqyrat financiare të Programit janë përgatitur në bazë të parasë së gatshme në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor. Mbi këtë bazë, të ardhurat njihen kur merren dhe jo kur fitohen dhe shpenzimet njihen kur paguhet dhe jo kur kryhen.

Shpenzimet e programit janë të kategorizuara në bazë të klasifikimit ekonomik dhe të produkteve buxhetore.

-Financimi i nga huaja e IBRD Nr. 9483-AL

Disbursimet gjate 2023 për rezultatet e arritura sipas marrëveshjes së huasë janë detajuar me poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
	Në Euro
DLR Nr. 2.1 Adoptimi i Standardeve të Përditësuara të Shërbimit Dixhital dhe Plani i Vlerësimit	1,800,000
Total	1,800,000

-Shpenzimet korrente të AKSHI-së (kontribut në Program)

Kontributi ne Program i shpenzimeve korrente te AKSHI-t për vitin 2023 është detajuar si më poshtë:

		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023				
		Në 000 lekë				
		Realizimi	Plani i rishikuar	Plani fillestar	Ndryshimet në planin vjetor	Ndryshimi vjetor (Plan-Realizim)
<i>Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI)</i>						
Pagat		423,096	450,621	596,877	(146,256)	27,525
Sigurimet shoqërore		63,524	72,000	112,000	(40,000)	8,476
Mallrat dhe shërbime të tjera		<u>5,864,409</u>	<u>6,592,098</u>	<u>5,792,098</u>	<u>800,000</u>	<u>727,689</u>
Totali i shpenzimeve korrente		<u>6,351,029</u>	<u>7,114,719</u>	<u>6,500,975</u>	<u>613,744</u>	<u>763,690</u>
Pagat (kontribut në Program)	20 %	84,619	90,124	119,375	(29,251)	5,505
Sigurimet shoqërore (kontribut në Program)	20 %	12,705	14,400	22,400	(8,000)	1,695
Mallrat dhe shërbime të tjera (kontribut në Program)	20 %	<u>1,172,882</u>	<u>1,318,420</u>	<u>1,158,420</u>	<u>160,000</u>	<u>145,538</u>
Totali i Shpenzimeve korrente (kontribut në Program)		<u>1,270,206</u>	<u>1,422,944</u>	<u>1,300,195</u>	<u>122,749</u>	<u>152,738</u>

-Shpenzimet korrente të AKSHI-së (kontribut në Program) në 000 lekë

Mallrat dhe shërbimet detajohen më tej si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Kontributi ne %	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
	AKSHI		Programi
Kostoja e mirëmbajtjes së sistemeve	4,164,799	20%	832,960
Shpenzime të tjera korrente	1,699,610	20%	339,922
Total	5,864,409		1,172,882

Shpenzime kapitale të trupëzuara

Angazhimet kapitale dhe shpenzimeve të realizuara nga AKSHI në kuadër të Programit janë prezantuar më poshtë:

Në 000 lekë	Realizimi	Plani i rishikuar	Ndryshimi vjetor (Plan- Realizim)	Vlera e kontratës	Angazhime t më 31 dhjetor 2023
<i>Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI)</i>					
Implementimi i Laboratorëve Smart	1,104,600	1,146,000	41,400	1,695,600	591,000
Total	1,104,600	1,146,000	41,400	1,695,600	591,000

Në datën 24 tetor 2023, AKSHI nënshkroi kontratën për “Zbatimin e Laboratorëve Smart”, me vlerë totale 1,695,600,000 lekë (me TVSH) me një afat deri më 24 korrik 2024. Qëllimi i kësaj kontrate është implementimi i 200 laboratorëve Smart në shkolla të ndryshme të Shqipërisë me synim përmirësimin e infrastrukturës edukative duke siguruar mjete moderne teknologjike dhe pajisje laboratorike. Laboratorët Smart do të mbështesin integrimin e teknologjisë së avancuar në proceset mësimore, duke promovuar inovacionin dhe përmirësimin e aftësive digjitale të studentët. Shkollat ku do të implementohen laboratorët Smart përfshijnë shkolla fillore dhe shkolla të ciklit të ulët (klasat 1 deri 3), si dhe disa shkolla kolektive dhe shkolla remote, me një fokus të veçantë në përfshirjen e komuniteteve të marginalizuara, përfshirë nxënësit romë.

Shpenzime kapitale të trupëzuara

Në kuadër të realizimit të projektit, AKSHI deri më 31 Dhjetor të vitit 2023, ka realizuar shpenzime te cilat përfshijnë blerjen dhe shpërndarjen e pajisjeve kryesore të projektit për shkollat, përfshirë pajisjet teknologjike dhe ato për siguri dhe rrjet. Këto shpenzime përfaqësojnë fazën e parë të implementimit të projektit, dhe procesi i instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve do të vazhdojë në muajt në vijim.

2.1. Auditimi i llogarive 600 – 606, shpenzimet korrente të AKSHI-t.

Baza ligjore dhe nënligjore ku mbështetet veprimtaria e AKSHI – t lidhur me çështjen “*Auditimi i llogarive 600-606 (shpenzimet korrente)*”.

-Ligji Nr. 45/2023 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për “*Përmirësimin e Aksesit të Barabartë në Shërbimet Publike të Standardit të Lartë Nëpërmjet Operacionit Govtech*”

-Ligji Nr. 10296, Datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar dhe Aktet Ligjore në zbatim të tij;

-Vkm Nr. 673, Datë 22.11.2017 “*Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*”, i ndryshuar;

- Vkm Nr. 710, Datë 21.08.2013 “*Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit*”, i ndryshuar;

- Rregulloret Përkatese të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;

- Kontratat e lidhura

-Udhëzimi nr.8 datë 09.03.2018, “Për procedurat e Përgatitjes-Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të NJQP dhe Udhëzimi-nr.30, datë-27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;

- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative

Me qëllim vlerësimin e rregullshmërisë së kryerjes së pagesave, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga AKSHI u përzgjedhën për auditim mbi bazë të numrit dhe vlerës së transaksioneve, kontratat e lidhura ndërmjet AKSHI dhe operatorëve ekonomik si më poshtë:

1. I. S.
2. I.
3. M. A.
4. In. S.
5. A. B. S. – Abs
6. A.s.
7. Og.
8. On.
9. A. S.C.
10. B. C.
11. C. P.
12. D.L.
13. F.
14. FI.
15. H.
16. I.&C. D.
17. I. +

18. K. C.P. N.
19. O. A.
20. P. A.
21. R & T
22. R. – C.
23. S. & S.
24. T.
25. U.R.T
26. V. A.

Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimin të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në AKSHI, u konstatua se veprimet janë kryer konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, dt. 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe Manualit të MFK- së. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve), konform pikës 35 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik" dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit sipas programit të sipërcituar konstatohet:

- AKSHI, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka lidhur kontratën:
 - o Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022 me subjektin A.S. C., në cilësinë e Kontratorit, për ofrimin e shërbimit “*Shërbimet e ndërlydhjes së DPGJC së me zyrat e saj rajonale- për DPGJC*”.
 - o Kontrata nr. Prot. 4881, datë 14.09.2023 me bashkimin e operatorëve ekonomikë A. S. C. shpk dhe A. sh.a, në cilësinë e Kontratorit, për ofrimin e shërbimit “*Loti 2 - Shërbim internetit dhe intranetit për institucionet publike*”–Seksioni–Internet për shkollat pjesë e Korçë dhe DRAP Durrës”
 - o Kontrata nr. Prot. 4879, datë 14.09.2023 me bashkimin e operatorëve ekonomikë . S. C. shpk dhe A. sh.a, në cilësinë e Kontratorit, për ofrimin e shërbimit “*Loti 2 - Shërbim internetit dhe intranetit për institucionet publike*”–Seksioni–Internet për Degët e Thesarit në Rrethe, për nevojat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,”.
 - o Kontrata nr. Prot. 5607, datë 10.10.2023 me bashkimin e operatorëve ekonomikë . S. C. shpk dhe A. sh.a, në cilësinë e Kontratorit, për ofrimin e shërbimit “*Shërbim internetit dhe intranetit për institucionet publike*”–Seksioni–Internet për AZHBR, IKMT, ARRSH, SHGJSH, Instituti i transportit, Pallati i Kongreseve, Cirku Kombëtar dhe drejtoria e Inspektimit Hekurudhor,”.
 - o Kontrata nr. Prot. 5979, datë 24.10.2023 me bashkimin e operatorëve ekonomikë . S. C. shpk dhe A. sh.a, në cilësinë e Kontratorit, për ofrimin e shërbimit “*Shërbim internetit dhe intranetit për institucionet publike*”–Seksioni–Internet për tre pika të qendrës Shëndetësore nr.1 dhe zyrat e QKEDH,”.

Nga auditimi i praktikave të urdhër shpenzimeve për muajt e përzgjedhur mbi bazë risku, nuk u konstatuan parregullsi në kryerjen e pagesave. Urdhër-shpenzimet janë nënshkruar elektronikisht nga NA, NZ, nëpunësi i thesarit dhe regjistruesi; si dhe janë të shoqëruara me faturën e lëshuar në përputhje me kontratën, raportin mujor të mirëmbajtjes, dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim nga komisioni i mbikëqyrjes. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të përmbledhura urdhër shpenzimet e audituara.

USH	Date	Vlera	Sherbimi	Kontrata
833	02.08.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
834	02.08.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
836	02.08.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
837	02.08.2024	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
1417	05.12.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
1418	05.12.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
1419	05.12.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
1461	15.12.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
1462	15.12.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
747	10.07.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
748	10.07.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
749	10.07.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
750	10.07.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
751	10.07.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
752	10.07.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
753	10.07.2023	10,773,780	Shërbime te ndërlidhjessë DPGJC-së me zyrat e saj rajonale-për DPGJC,	Kontrata nr. Prot. 6, datë 20.04.2022
1658	16.01.2024	13,726,350	Shërbim internetit dhe intranetit për institucionet publike”-Seksioni-Internet për shkollat pjesë e Korçë dhe DRAP Durrës	Kontrata nr. Prot. 4881, datë 14.09.2023
1660	16.01.2024	7,324,691	Shërbim internetit dhe intranetit për institucionet publike”-Seksioni-Internet dhe Intranet për Degët e Thesarit në Rrethe, për nevojat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,	Kontrata nr. Prot. 4879, datë 14.09.2023
1595	04.01.2024	3,419,408	Akshi-Shërbim internetit dhe intranetit për institucionet publike”-Seksioni-Internet për AZHBR, IKMT, ARRS,SHGJSH, Instituti I transportit,Pallati iKongreseve,Cirku Kombëtar dhe drejtoria e Inspektimit Hekurudhor	Kontrata nr. 5607, datë 10.10.2023
1596	04.01.2024	241,536	Shërbim internetit dhe intranetit për institucionet publike”-Seksioni-Internet për tre pika të qendrës Shëndetësore nr.1 dhe zyrat e QKEDH	Kontrata nr. 5979, datë 24.10.2023
Totali		197,092,465		

- AKSHI, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka lidhur kontratën nr. Prot.4881, datë 08.08.2022 me bashkimin e operatorëve ekonomikë I. S. shpk dhe X. It S. GmbH, në cilësinë e Kontraktorit, për ofrimin e shërbimit “*Mirëmbajtja e Sistemit të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile*”. Nga auditimi i praktikave të urdhër shpenzimeve për muajt e përzgjedhur mbi bazë risku, nuk u konstatuan parregullsi në kryerjen e pagesave. Urdhër-shpenzimet janë nënshkruar elektronikisht nga NA, NZ, nëpunësi i thesarit dhe regjistruesi; si dhe janë të shoqëruara me faturën e lëshuar

në përputhje me kontratën, raportin mujor të mirëmbajtjes, dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim nga komisioni i mbikëqyrjes. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të përmbledhura urdhër-shpenzimet e audituara.

USH	Date	Vlera në lekë	Sherbimi
184	02.03.2023	11,128,670	AKSHI-Miremb.Sist. Rregjistri kombetar I gjendjes civile
416	02.05.2023	5,564,885	AKSHI-Miremb.Sist. Rregjistri kombetar I gjendjes civile
1108	05.10.2023	5,564,827	AKSHI-Miremb.Sist. Rregjistri kombetar I gjendjes civile
1402	04.11.2023	5,564,805	AKSHI- Miremb.Sist. Rregjistri kombetar I gjendjes civile
Totali		27,823,187	

- Me USH nr. 1269, datë 09.11.2023 është kryer pagesa për subjektin H. L. P. LLP, në vlerën 4,534,517.69 lekë, për shërbimin e konsulencës ligjore, në zbatim të kontratës datë 29.07.2022 dhe shkresës së Avokaturës së Shtetit me nr. Prot. 2768, datë 29.05.2023. Urdhër-shpenzimi është nënshkruar elektronikisht nga NA, NZ, nëpunësi i thesarit dhe regjistruesi; si dhe janë të shoqëruara me faturën dhe urdhrin nr. 6362 prot, datë 07.11.2023 të Titullarit të Akshi-t për kryerjen e pagesës.
- Me USH nr. 286, datë 05.04.2023 është kryer konvertim i vlerës 2,300,000 lekë nga valuta Lekë në valutën Euro, me kursin 115, me autorizimin e Titullarit të Akshi-t nr. 1655, datë 03.04.2023.

-Nga auditimi konstatohet se, nëpërmjet arkës në valutë janë kryer kryesisht pagesa për shërbime udhëtimi e dieta jashtë vendit. Në të gjitha rastet e audituara, paradhënia ka rezultuar të jetë sistemuar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e-Gov dhe Tik dhe Shërbimeve Mbështetëse, menjëherë pas paraqitjes së dokumenteve justifikuese për shpenzimet e kryera, nga ana e nëpunësit udhëtues, e shoqëruar kjo sipas rastit me Mandat Pagesën ose Mandatin e Arkëtimit. Transaksionet financiare, në formën e paradhënies, për udhëtime e dieta, rezultojnë të kryera në zbatim të VKM nr. 870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Nga auditimi u konstatua se regjistrimet kontabile për veprimet e arkës kryhen në mënyrë manuale në program “Excel”, situatë kjo që rrit riskun e gabimeve dhe ruajtjes së të dhënave, veprime në kundërshtim me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” i miratuar me Urdhrin nr. 108. Dt. 17.11.2016 të Ministrisë të Financave, kapitulli III.

- AKSHI, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka lidhur kontratën:
 - o Kontrata nr. Prot.23 datë 24.08.2022 me subjektin C. P. Shpk, për ofrimin e shërbimit “Përmirësimi i sistemit FER-për DPPSH”.
 - o Kontrata nr. Prot.4718 datë 06.07.2021 me subjektin C. P. Shpk, për ofrimin e shërbimit “Mirëmbajtje e Regjistrimit Noterial Shqiptar”
 - o Kontrata nr. Prot.1726 datë 23.03.2021 me subjektin C. P. Shpk, për ofrimin e shërbimit “Ngritja e sistemit elektronik për menaxhimin e ankesave në KPP”.
 - o Kontrata nr. Prot.8355 datë 06.12.2021 me subjektin C. P. Shpk, për ofrimin e shërbimit “Mirëmbajtje e sistemit ATP WEB-GIS-për Agjencinë e Trajtimit të Pronave”
